



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
KËSHILLI

Nr. 4233/Prot.

Pogradec, më 22.09.2022

VENDIM

NR 101, DATË 20.09.2022

PËRNJË NDRYSHIM NË PIKËN 2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK  
POGRADEC ME NR. 83, DATË 19.07.2022

Në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 12 të nenit 23, në shkronjën "b" dhe shkronjën "gj" të nenit 64 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në Ligjin Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 83 ,datë 19.07.2022 "Për një ndryshim në VKB-në Nr.72, datë 17.08.2021, "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak Pogradec Nr.108 datë 21.10.2020 Për miratimin e normave,kritereve,rregullave dhe procedurave për marrje ambient dhe objekti me qira, për të shërbyer si kopështe", i konfirmuar me shkresën e Prefekturës Korçë, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit",si dhe mbështetur tek Relacioni shpjegues i Qendrës Arsimore përfshatin Buzaishte të Njësisë Administrative Velçan.

KËSHILLI I BASHKISË  
VENDOSI :

1. Të ndryshohet pika 2 e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 83,datë 19.07.2022"Për një ndryshim në VKB-në Nr.72,datë 17.08.2021, "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak Pogradec Nr.108 datë 21.10.2020 Për miratimin e normave,kritereve,rregullave dhe procedurave përmarrje ambient dhe objekti me qira, për të shërbyer si kopështe",duke qenë se për fshatin Buzaishte të Njësisë Administrative Velçan ka lindur nevoja për një ambient tjetër shtesë për ta marrë me qera, krahas ambjentit që do të shërbejë si kopsht duhet dhe një ambient që të shërbejë si shkollë për vitin shkollor 2022- 2023.
2. Vlera e qirasë mujore për ambientin shtesë që do të shërbejë si shkollë në fshatin Buzaishtë në Njësinë Administrative Velçan të mos e kalojë vlerën 6000 lekë.



**Mbështetur në Vendimet e sipërpërmendura të Këshillit të Bashkisë Pogradec do të lidhen kontratat për vitin e ri arsimor 2022 – 2023.**

3. Për zbatimin e vendimit , ngarkohet Kryetari i Bashkisë , Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e bashkisë Pogradec.
4. Ky vendim hyn në fuqi ,10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Sotiraq MANGËRI**

